



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/323
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K4/I60-10 Prot.
Nr. Dok. 202503140/10

Tiranë _11_/_12_/2025

Lënda: Rekomandohet marrja e masave për parandalimin e rasteve të vdekjeve të burgosurve për shkak të neglizhencës së stafit të IEVP dhe të vlerësimit më saktë të rrezikut për gjendjen shëndetësore që paraqet një i burgosur.

Drejtuar: DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BURGJEVE

TIRANË

INSTITUCIONIT TË EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE

JORDAN MISJA TIRANË

Të nderuar,

Në datë 24.07.2025, në media është bërë publik lajmi, se i paraburgosuri Besnik Koçiu i ndodhur në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale "Jordan Misja" Tiranë dyshohet se ka ndërruar jetë në spital, si pasojë e një arresti kardiak. Mësohet se viktimi ishte 51 vjeç dhe ishte i paraburgosur nën akuzën e veprave penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit", parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal, arrestuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë dhe ardhur në IEVP "Jordan Misja", Tiranë më datë 16.07.2025¹.

Me marrjen dijeni të këtij lajmi, Institucioni i Avokatit të Popullit në përmbushje të misionit të tij kushtetues e ligjor për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit, nga veprimet dhe mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike ngriti grupin e punës, me qëllim verifikimin e situatës në vend, si dhe intervistimin e bashkëvuajtësve dhe të stafit të IEVP Jordan Misja Tiranë, në lidhje me ngjarjen e rëndë të ndodhur në këtë institucion.

Për të kuptuar nëse kjo ngjarje mund të parandalohej janë kryer veprimet hetimore si vijon: marrja e shpjegimeve verbale nga drejtori i IEVP Jordan Misja (313) Tiranë, z. Gentian

¹ <https://shqiptarja.com/lajm/u-gjet-pa-ndjenja-ne-qeli-nderron-jete-ne-qsut-i-paraburgosuri-ne-tirane-ishte-arrestuar-per-nje-plagosje-emri>

Lila; marrja e shpjegimeve verbale nga shefja e shërbimit të shëndetësisë znj. Bajrame Molla (e komanduar); këqyrja e vendit ku i paraburgosuri Besnik Koçiu është gjetur pandjenja; këqyrja e regjistrave të aktivitetit 24-orësh të hyrje-daljeve të të burgosurve e të personelit, të librit të lënies së detyrave në seksionin ku ka ndodhur ngjarja të regjistrat të terapisë mjekësore, pamjet filmike, dhe këqyrja e dosjes psiko-sociale të të paraburgosurit Besnik Koçiu.

Gjithashtu nga ana jonë janë administruar dhe korrespondencat me institucionet e tjera përgjegjëse.

Sipas deklaratimit të drejtorit të IEVP-së “Jordan Misja” 313 Tiranë, z. Gentian Lila i paraburgosuri Besnik Koçiu ishte akomoduar në këtë institucion më datë 16.07.2025. Me ardhjen e tij në institucion, i paraburgosuri është vendosur në ambientet e observimit, në godinën A, kati 1, sektori 3, dhoma nr. 7, dhe pas përfundimit të periudhës së observimit, i paraburgosuri në datë 21.07.2025 është lëvizur nga ato ambiente dhe është sistemuar në godinën B, sektori 1, dhoma 6 për shkak të kushteve më të mira të akomodimit që ofron godina B.

Gjithashtu, z. Lila na informoi se me datë 24.07.2025, ora 07:00, e mëngjesit në kohën kur po u ndërronin turnin e parë, inspektori i policisë z. Dilaver Broshka, konstaton se paraburgosuri Besnik Koçiu, ishte i shtrirë në krevat dhe pas thirrjes së policit ai nuk është përgjigjur dhe menjëherë është njoftuar përgjegjësi i shërbimit dhe infermieri i turnit në shërbim. Po ashtu, është referuar nga ana e tyre në orën 07:03 minuta, se i paraburgosuri ka probleme të rënda shëndetësore dhe është në gjendje të fikti, me cianoze rreth buzës, me shkurmbë nga goja, nuk prekej pulsi, injekton Sol.Adreline subkutan dhe është rekomanduar dërgimi i të paraburgosurit në Urgjencën e Qendrës Spitalore Universitare Nënë Tereza, Tiranë (QSUT). Ndërkohë në orën 07:08 minuta, i paraburgosur del nga institucioni dhe në orën 07:12 minuta ka arritur në QSUT. Rreth orës 08:00 jemi njoftuar nga mjeku urgjencës në QSUT se Besnik Koçiu ka ndërruar jetë për shkak të exitus letalis (vdekje) me diagnozë. suspekt arrest kardiak.

Ndërsa, në deklaratimin e shefit të shërbimit shëndetësisë znj. Bajrame Molla (e komanduar), ndër të tjera u informuam se, që në momentin e pranimit në institucion i paraburgosuri kishte referuar se trajtohej për disa diagnoza komplekse si: Diabet Mellitus tip. 2, nën insulin, HTA st. III, Dislipidemi. Po ashtu, i paraburgosuri ka referuar se para 6 muajsh kishte kaluar AVC ischemic akut. Gjithashtu, u informuam se shtetasi Besnik Koçiu gjatë ditëve të para të akomodimit tij, kishte ngritur në mënyrë vazhdueshme probleme shëndetësore, si dhimbje koke dhe dobësi trupi por sipas konstatimeve të personelit mjekësor parametrat e tij ishin normalë dhe ishte rekomanduar kryerja e ekzaminimeve laboratorike të tij në vijim.

Nga këqyrja e kartelës klinike nr.6303, datë 16.07.2025, rezulton se me datë 18 dhe 22 Korrik 2025, shtetasi Besnik Koçiu kishte paraqitur ankesë për dhimbje koke, dobësi trupore, djegie gjoksi dhe lodhje. Gjithashtu, u konstatua se ankesa të tilla ishin të vazhdueshme. Për këtë arsye, më datë 21.07.2025, shtetasi ishte transferuar nga Godina A ku kishte qëndruar deri në atë moment, drejt Godinës B të institucionit, fillimisht në dhomën nr. 2, bashkë me 3 shtetas të tjerë, por për shkak të gjendjes jo të mirë shëndetësore dhe shqetësimeve që paraqiste, ai në të njëjtën ditë ishte transferuar sërish, kësaj here drejt dhomës 6 kati parë sektori 2 godina B, ku kishte qëndruar i vetëm, për shkak të kushteve më të mira të akomodimit që ofron.

Gjendja e tij jo e mirë shëndetësore, rezulton të ketë qënë e dukshme edhe për punonjësit e policisë në sektor, pasi për datën 22.07.2025, në Librin e Lënies së Detyrave, nga Specialisti i Policisë me initiale G.R, ishte lënë shënimi: Të mbahet nën vëzhgim vazhdimisht i paraburgosuri i dhomës nr. 6, kati 1, sektori 2, shtetasi Besnik Koçiu e të informohet specialisti i informacionit për çdo shqetësim. Ndërsa referuar këqyrjes së regjistrave në datën 23.07.2025 nuk rezulton të ishin mbajtur praktika të dokumentuara apo evidentime për gjendjen shëndetësore të të paraburgosurit Besnik Koçiu dhe kontrollin e tij.

Nga kqyrja e librit e aktivitetit 24 orësh, ishin mbajtur shënime se mbrëmjen e datës 23.07.2025, në orën 20:45, i paraburgosuri Besnik Koçiu ishte pa qejf. Në orën 21:00 dhe 22:05 minuta, kishte shkuar në dhomën e tij ndihmës mjekja e cila i kishte matur tensionin. Rezulton që prej këtij momenti, për afro 9 orë deri mëngjesin e nesërm të datës 24.07.2025 ora 07:00 kur është gjetur pa ndjenja nuk ka asnjë praktikë që të dokumentojë njoftimin e mëtejshëm të gjendjes së tij shëndetësore nga ana e stafit policor apo atij shëndetësor.

Mungesa e këtyre shënimeve përbën boshllëk të konsiderueshëm në dokumentimin e kujdesit që duhej ofruar gjatë kësaj periudhe kritike, e po ashtu ngre dyshime serioze mbi mënyrën e monitorimit të gjendjes së të paraburgosurit. Kjo situatë sugjeron se nuk janë ndjekur procedurat standarde të vëzhgimit dhe raportimit, të cilat kërkojnë që çdo ndryshim në gjendjen shëndetësore të personit të dokumentohet në kohë reale dhe me saktësi, aq më tepër kur ka pasur dhe shënime e detyra të mëparshme në regjistër, si dhe ankesa nga vetë personi.

Mospasqyrimi i këtyre veprimeve në regjistër jo vetëm që cenon transparencën dhe përgjegjshmërinë e stafit përkatës, por edhe vështirëson rikrijimin e rrethanave të sakta të ngjarjes dhe vlerësimin profesional të kujdesit që ai ka marrë gjatë asaj kohe.

Sipas deklarimeve të marra nga të paraburgosurit që kanë qënë të akomoduar në të njëjtën dhomë me Besnik Koçiun, konkretisht në dhomën nr. 2 të godinës B, rezulton se ai ka shprehur vazhdimisht shqetësime për gjendjen e tij shëndetësore. Ata kanë pohuar se i paraburgosuri ka rënkuar dhe ka bërtitur me zë të lartë, duke kërkuar ndihmë për gjendjen e tij.

Pas transferimit të tij në dhomën nr. 6, ai është strehuar i vetëm deri në momentin kur është gjetur pa ndjenja, rezulton se pas orës 22:05 min kur është kryer vizita nga nd/mjekja, i ndjeri nuk është observuar më nga stafi përkatës. Në kushtet e gjendjes së tij shëndetësore dhe pa një person tjetër në dhomë ka qënë e nevojshme kujdesi i shtuar për observim të paktën çdo orë me qëllim konstatimin e gjendjes së tij shëndetësore.

Sipas hetimit administrativ, rezulton se i paraburgosuri ka rënkuar dhe bërtitur me zë të lartë gjatë gjithë ditës të datës 23.07.2025 deri në orët e para të mëngjesit të datës 24.07.2025, kur është gjetur pa ndjenja, për shkak të rëndimit të gjendjes së tij shëndetësore. I paraburgosuri ka pasur nevojë për ndihmë mjekësore gjatë gjithë kësaj periudhe. Rojet e sigurisë kanë detyrimin të njoftojnë menjëherë stafin shëndetësor në çdo rast kur një i paraburgosur paraqet shqetësime shëndetësore, por edhe stafi shëndetësor duhet të kishte lënë shënime për vemendje të shtuar. Mosinteresimi gjatë natës ndaj ankesave dhe renkimit të një burgosuri në rastin më të mirë përbën neglizhencë në kryerjen e detyrave.

Sipas materialit të mbledhur rezulton se, i paraburgosuri Besnik Koçi ka qëndruar i akomoduar në IEVP “Jordan Misja” 313 Tiranë, për rreth 8 ditë, por pavarësisht kërkesave të tij të përsëritura për tu dërguar në spital, një gjë e tillë nuk ishte realizuar për shkak se sipas konstatimeve të personelit mjekësor parametrat e tij ishin normalë dhe ishte rekomanduar kryerja e ekzaminimeve laboratorike të tij në vijim.

Institucioni i Avokatit të Popullit, vëren me shqetësim faktin që diagnozat komplekse të të paraburgosuri Besnik Koçi, si dhe pretendimet për probleme vazhdueshme shëndetësore të komfirmuara edhe nga ankesat e vazhdueshme të tij, drejtuar stafit shëndetësor dhe policor, kërkonin një reagim të shpejtë për ekzaminim dhe trajtim të specializuar të tij menjëherë pas pranimit të tij në IEVP. Ekzaminimi dhe mbikëqyrja e vazhdueshme e gjëndjes shëndetësore të shtetasve që akomodohen në ambientet e institucioneve të privimit të lirisë është detyrim ligjor, për stafin e IEVP-së, me qëllim parandalimin e rasteve të humbjes së jetës apo vetëvrajsve të shtetasve të privuar nga liria, në institucione të Ekzektumeve të Vendimeve Penale². Gjithashtu, shërbimi i kujdesit shëndetësor duhet të sigurohet 24 orë dhe në rast sëmundjesh, të cilat nuk mund të diagnostikohen apo kurohen në këto institucione, shtetasve të burgosur u njihet e drejta e transferimit pranë Qendrës Spitalore të Burgjeve apo Qendrës Spitalore Universitare Tiranë³.

Sipas pamjeve filmike, të datës 24.07.2025, në kamerën e sigurisë me nr.204, koridorin e sektorit 2 godina B, shikohet se në orën 07:00:44 sek, shikohet punonjësi i policisë, duke bërë apelin e të burgosurve në sektor. Në vijim të pamjeve filmike punonjësi i policisë, largohet me vrap në drejtim të kollonës dhe më pas duket grupi i sigurisë bashkë me ndihmësmjekun që vrapon në drejtim të dhomës nr. 6 të shtetasit Besnik Koçi. Në orën 07:03:27 sek, i paraburgosuri del me barrelë nga sektori nr.2 godina B. Në vëzhgimin e pamjeve të kamerës nr. 173, ora 07:04:48 minuta, i paraburgosuri del me barrelë nga regjimi i brendshëm. Në orën 07:08 minuta, automjetin që transporton të paraburgosurin Besnik Koçi, del nga porta e kryesore e IEVP-së.

Nga mbikëqyrja e ambientit të dhomës nr.6, të sektorit 2 të godinës B ku i paraburgosuri banonte vetëm dhe u gjet në gjendje të rëndë shëndetësore, rezulton se dhoma ishte me sipërfaqe 4m², dritarja e kësaj dhome ishte me përmasa të mjaftueshme dhe mundësonte futjen e sasisë së konsiderueshme të ajrit dhe të dritës natyrale. Nga vlerësimi i kushteve materiale të dhomës, ishte sipas parametrave teknike jetësore të përcaktuar në legjislacionin kombëtar ku thuhet se norma minimale e hapësirës për person, në institucione të tilla është 6 m² për dhomat për një person dhe 4 m² kur në to sistemohen më shumë persona. Në këtë normë nuk mbahet parasysh sipërfaqja e tualetit, që mund të ndodhet brenda dhomës.

² Neni 15 Të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve parashikohet se “menjëherë pas pranimit në institucion, i burgosuri i nënshtrohet një vizite ekzaminuese dhe interviste mjekësore nga ana e mjekut dhe e psikologut, për njohjen e gjëndjes shëndetësore fizike dhe psikologjike, me qëllim parandalimin e përhapjes së sëmundjeve ngjyeshme në institucion apo vetëvrasjeve”.

³ Neni 41 pika 14 të ligjit nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, ku thuhet se “Në raste urgjence, kur rrezikohet jeta e të burgosurit, ai transferohet për mjekim në qendrën spitalore të burgjeve ose në institucionet e kujdesit shëndetësor rajonal”.

Në kuadër të hetimit administrativ, nga ana jonë i është kërkuar informacion dhe dokumentacion Institutit të Mjekësisë Ligjore Tiranë⁴, Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë⁵, Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë⁶.

Instituti i Mjekësisë Ligjore me anë të shkresës me numër 7674/1 prot, datë 07.08.2025, dhe me shkresën nr. 7674 prot, datë 24.10.2025, na informon se akti i ekspertimit mjeko ligjor mbi shkakun e vdekjes së shtetasit të ndjerë Besnik Koçiu është ende në procesë në pritje të ekzaminimeve të nevojshme për këtë ekspertim.

Në përgjigje të shkresës tonë, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë me anë të shkresës me numer 1861/6 prot, datë 13.08.2025, na informon ndër të tjerat se shtetasi Besnik Koçiu është sjellë në Urgjencën Polivalente me autoambulancën e Burgut 313 me datë 24.07.2025, në orën 07:12 minuta, i shoqëruar nga personeli mjekësor dhe Policia, me nr. i regjistri 66977, ku rezulton se shtetasi Besnik Koçiu, ka ndërruar jetë për shkak të exitus letalis(vdekje) me Dg. suspekt arrest kardiak.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me anë të shkresës me numer 21627 prot, datë 23.09.2025, na informon se në lidhje me vdekjen e shtetasit Besnik Koçiu, në ambientet e IEVP “Jordan Misja”, 313 Tiranë, është regjistruar kallëzimi penal nr.12143 i vitit 2025, dhe çështja vijon ende të fazën e hetimeve paraprake.

Në përfundim të hetimit tonë administrativ, të kryer në IEVP “Jordan Misja” (313) Tiranë dhe pas vlerësimit të informacioneve dhe dokumentacionit të administruar, konstatojmë se:

- Nga këqyrja e kartelës shëndetësore, i paraburgosuri Besnik Koçiu, trajtohej për disa diagnoza komplekse si: Diabet Mellitus tip. 2, nën insulin, HTA st. III, Dislipidemi. Pavarësisht kërkesave të tij të përsëritura për tu dërguar në spital, lidhur me këtë problematikë konstatojmë se nuk kemi referim për ndjekjen e rastit të paraburgosurit dhe as ndonjë trajtim të veçantë apo referim tek mjeku specialist.
- Nga verifikimi i Librit të aktivitetit 24 orësh, sipas shenimeve përkatse rezulton se që prej mbrëmjes të datës 23.07.2025, ora 22:05 minuta deri në mëngjes të datës 24.07.2025, në orën 07:00 kur është gjetur pa ndjenja i paraburgosuri Besnik Koçiu, për afro 9 orë nuk ka asnjë shënim që të dokumentojë njoftimin e mëtejshëm të gjendjes së tij shëndetësore nga ana e stafit policor apo atij shëndetësor.

Avokati i Popullit vëren, se në rastet kur kërkohet për nga natyra e gjendjes shëndetësore, mbikëqyrja mjekësore duhet të jetë e rregullt dhe sistematike që përfshin një terapi gjithëpërfshirëse që synon trajtimin e duhur të problemeve shëndetësore të të dënuarve dhe të paraburgosurve ose parandalimin e përkeqësimit të tyre, në vend të trajtimit mbi baza simptomatike të gjendjes shëndetësore të të burgosurve.

- Dinamika e ngjarjes tregon qartë neglizhencën e stafit shëndetësor, për dërgimin e të paraburgosurit në spital, duke humbur kohën e vlefshme për ta dërguar atë sa më parë në një institucion ku mund të merrte trajtim më të specializuar dhe mund të shpëtohej një jetë.

⁴ Shkresë nr. K4/I60-2 prot, datë 30.07.2025

⁵ Shkresë nr. K4/I60-3 prot, datë 30.07.2025

⁶ Shkresë nr. K4/I60-2 prot, datë 27.08.2025

Në vlerësimin tonë, procedura e përcaktimit të mjekimit të nevojshëm, të kohëzgjatjes së përdorimit të medikamenteve si dhe rekomandimeve të nevojshme për kontrolle apo veprime të mëtejshme, duhet të jetë e menjëhershme dhe në rast sëmundjesh, të cilat nuk mund të diagnostikohen apo kurohen në këto institucione, shtetasve të burgosur u njihet e drejta e transferimit pranë Qendrës Spitalore të Burgjeve apo Qendrës Spitalore Universitare Tiranë. Kjo duhet të zbatohet në të gjitha IEVP-të për të mos lënë mundësi për të mos sjellë asnjë pasojë në gjendjen shëndetësore të të burgosurve apo dhe që të ngrihen pretendime, qoftë nga të burgosurit apo familjarët e tyre. Ndjekja e saj me rigorozitet do ta bënte efektive të drejtën e të burgosurve për shërbime dhe kujdes shëndetësor, si një nga garancitë e parashikuara në aktet ligjore që lidhen me trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve.

Për sa më sipër, Avokati i Popullit në vijim të kryerjes së misionit kushtetues e ligjor, në rolin e nxitësit të standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend, bazuar në nenin 63 të pikës 3 të Kushtetutës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; të nenit 21, gërma “b” të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive, si dhe në bazë të nenit 81, pika 2/b të ligjit Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”*, ku parashikohet midis të tjerash se: *“Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka këto kompetenca:b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues”*.

REKOMANDOJMË:

1. Analizimin me hollësi të rastit nga strukturat kompetente të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, për stafin shëndetësor dhe punonjësit e Policisë së Burgjeve, në IEVP Jordan Misja (313) Tiranë, në objekt të këtij hetimi administrativ dhe nxjerrjen e përgjegjësiave përkatëse, në funksion të një sjelljeje korrekte të ofrimit cilësor të shërbimit dhe të trajtimit të të burgosurve sipas ligjit.
2. Marrjen e masave të menjëhershme për sigurimin e shërbimit shëndetësor të të burgosurve pa ndërprerje nën kujdesin dhe kontrollin e personelit mjekësor.
3. Marrjen e masave të menjëhershme nga Institucioni i Ekzekutimit të Dënimeve Penale “Jordan Misja”, (313), Tiranë që mbikëqyrja mjekësore të të jetë sistematike, me terapi gjithëpërfshirëse që synon trajtimin e duhur të problemeve shëndetësore të burgosurve për parandalimin e përkeqësimit dhe dërgimin e tyre për vizitë menjëherë te mjeku specialist në struktura të specializuara.
4. Marrja e masave disiplinore për mangësitë e evidentuara në trajtimin e këtij rasti.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, kërkojmë të vihem në dijeni, brenda afatit 30 ditor, sipas nenit 22 të Ligjit Nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

**KOMISIONERI
i Mekanizmit Kombëtar
për Parandalimin e Torturës
(MKPT)**

Ahmet PRENÇI

dv